

GJETJET NGA HULUMTIMI MARS, 2014

Të gjeturat kryesore nga hulumtimi i fundit për sigurinë e fëmijëve në internet i bërë nga Qendra për Studime të Avancuara FIT dhe Save the Children në Kosovë tregojnë se:

93% e fëmijëve të anketuar janë përdorues të internetit, ndërsa 63% e tyre e përdorin internetin çdo ditë ose gati çdo ditë;

84% e fëmijëve kanë llogari personale aktive në Facebook ose Twitter, prej të cilëve 32% kanë mbi 400 miq;

38% e fëmijëve kanë raportuar se kanë shikuar pamje me përmbajtje pornografike, 28% e këtyre fëmijëve kyqen në internet në shkollë, që nuk përjashton mundësinë se këto pamje mund t'i kenë parë edhe në shkollë;

61% ke fëmijëve kanë deklaruar që kanë parë foto ose video me përmbajtje luftarake dhe agresive;

58% e fëmijëve kanë deklaruar se kanë kontaktuar përmes internetit me persona të panjohur, 69% e të cilëve janë takuar edhe personalisht me ata persona;

25% e fëmijëve kanë pohuar që zihen në shkollë me shokët/shoqet për shkak të asaj se çfarë ka ndodhur paraprakisht në internet apo në rrjetet sociale.

KËSHILLA TË PËRGJITHSHME PËR ARSIMTARË

Ju sugjerojmë që sa më pak t'i përdorni telefonat mobil gjatë procesit mësimorë, sepse ju jeni modeli kryesor për fëmijët.

Bisedoni sa më shumë me fëmijët dhe krijoni një ambient të përshtatshëm në klasë për këso lloj bisedash. Mësoni sa më shumë rreth gjërave që mund t'i bëni në internet; kështu do të jeni më të informuar se çfarë mund të bëjnë fëmijët gjatë përdorimit të internetit.

Krijoni një ambient sa më të përshtatshëm për fëmijët dhe krijoni rregulla të përgjithshme të klasës në lidhje me internetin.

Krijoni një listë të ueb faqeve të cilat janë të përshtatshme për fëmijët dhe inkurajoni ata që t'i vizitojnë.

Nuk është përfunduar që t'i bëni shokë/shoqe nxënësit në rrjete sociale, por mund të hapni ndonjë grup të klasës në Facebook.

Qendra për studime të avancuara FIT

Adresa: Rruga Eqrem Qabej, nr 166,
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

E-mail: info@fit-ks.org
www.fit-ks.org
www.internetisigurte.org

Save the Children

Gazmend Zajmi nr.1, 10000 Prishtine Kosove
Phone: +381 (0) 38 55 26 91
Fax: +381 (0) 55 26 90
scik@savethechildren.org
www.savethechildren.net
www.kosovo.savethechildren.net
www.facebook.com/savethechildreninkosova

SIGURIA E FËMIJËVE NË INTERNET



SI T'I MBROJMË NXËNËSIT NGA RREZIQET NË INTERNET?



RREZIQET NGA PËRDORIMI I RRJETEVE SOCIALE

Rreziqet më të shpeshta që fëmijët hasin gjatë përdorimit të internetit, sidomos rrjeteve sociale, janë:

Takimet me persona të panjohur të cilat mund të jenë shqetësuese për fëmijët;

Keqpërdorimi i informatave personale;

Publikimi i fotografive/videove me përmbajtje të papëlqyeshme;

Biseda me persona të ndryshëm përmes lojërave në internet.

Këshilla:

■ Inkurajoni fëmijët që mos t'i japin të dhënat personale në rrjetet sociale.

■ Tregoni fëmijëve se cilat fotografi/video janë të përshtatshme për t'u postuar duke ju thënë: "Nëse atë fotografi/video nuk keni dëshirë që ta shohin prindërit ose arsimtarët, më mirë është që të mos e postoni".

■ Këshilloni fëmijët që të mbyllin rrjetet e tyre sociale (Log out) pasi që të kenë mbaruar përdorimin e tyre.

SHIKIMI I PËRMBAJTJEVE JO ADEKUATE NË INTERNET

Gjatë përdorimit të internetit fëmijët mund të hasin në materiale jo adekuate si:

Video/fotografi të ndryshme me përmbajtje agresive dhe të papëlqyeshme në internet;

Video/fotografi me përmbajtje pornografike, me apo pa dëshirë;

Video/fotografi me përmbajtje të papërshtatshme në uebfaqe të ndryshme.

Këshilla

■ Kërkoni nga personeli i shkollës që të bëhet filtrimi i faqeve në internet në të cilat fëmijët mund të kenë çasje;

■ Kujdesuni që gjatë procesit mësimor fëmijët të mos përdorin telefona me kamerë dhe internet;

■ Këshilloni fëmijët që të konsultohen me ndonjë të rritur nëse shohin përmbajtje të papërshtatshme.

ÇKA ËSHTË SAJBËRDHUNA?

Sajberdhuna (ang. Cyberbullying) - është përdorimi i pajisjeve elektronike për të ngacmuar apo frikësuar dikë përmes mesazheve, fotografive dhe postimeve të tjera në internet. Fëmijët ngacmohen në rrjetet sociale apo në internet dhe pastaj e vazhdojnë konfliktin fizik, kryesisht nëpër shkolla.

Këshilla

■ Pyesni fëmijët rregullisht nëse dikush i ngacmon gjatë përdorimit të internetit, dhe ofroni mbështetjen tuaj në rast se janë të ngacmuar.

■ Punoni me personelin e shkollës për të gjetur mënyra të përbashkëta në luftimin e kësaj dukurie: psh implementimin e një mënyre të raportimit anonim në shkollë.

